



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 tetor 2024  
Nr. Ref.: RK 2544/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI10/24**

Parashtrues

**“Agrounion SH.P.K.”**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [K.Dh.Sh.II.nr.720/23] të 11 dhjetorit  
2023 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar në emër të “Agrounion SH.P.K.” nga Refik Shabani, pronar i kompanisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në Fushë Kosovë, i përfaqësuar në Gjykatë nga Shoqëria e Avokatëve “GHG” nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [K. Dh. Sh. II. nr. 720/23] të 11 dhjetorit 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë), në ndërlidhje me Aktgjykimin [KF. nr. 278/2022] e 14 prillit 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenet 1 të Protokollit Nr. 1, 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7, 8 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 11 janar 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI10/24] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues, dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI10/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
7. Më 30 janar 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

10. Më 20 mars 2024, Gjykata i kërkoi Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë që të dorëzojë në Gjykatë dosjen origjinale të lëndës.
11. Më 26 mars 2024, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë dorëzoi në Gjykatë dosjen origjinale të lëndës.
12. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, i drejtohet Gjykatës për herë të dytë. Gjykata rikujton se më 1 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës për herë të parë iu drejtua Gjykatës me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [KA. nr. 339/2016] të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Njoftimit [KMLK. nr. 7/16] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kërkesë të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI141/16. Kërkesa e atëhershme e parashtruesit të kërkesës nuk ndërlihet me kërkesën e tanishme KI10/24.
14. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës është kompani e cila merret me tregtimin e produkteve bimore dhe shtazore.
15. Më 12 dhjetor 2011, Zyra Doganore në Podujevë përmes Vendimit [nr. 37240/12.12.2011] konstatoi se malli lëndor i deklaruar nga parashtruesi i kërkesës për zhdoganim nuk klasifikohet si “fungicid” por klasifikohet, në kodin doganor 28332500, si “sulfat bakri” CuSO<sub>4</sub>-gur i kaltër, që i nënshtrohet pagesës së taksave doganore sipas Tarifës së Integruar të Kosovës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Doganën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Dogana) kërkesë për rishqyrtim të vendimit të lartcekur të Zyrës Doganore në Podujevë, me pretendimin se ri-klasifikimi i bërë nuk ishte i drejtë dhe se malli në fjalë bënte pjesë në grupin e preparateve kimike me bazë të bakrit të njohur si fungicid, i liruar nga pagesa e taksave doganore.
17. Më 7 mars 2012, Dogana, përmes Aktvendimit [05.2.1/1244] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të Vendimit [Nr. 37240/12.12.2011] të Zyrës Doganore në Podujevë, me arsyetimin se nga Mendimi i klasifikimit tarifor nr. 53/2011 të 16 dhjetorit 2011, të lëshuar nga Sektori i Tarifës, ishte dëshmuar se malli kontestues ishte sulfat bakri CUSo<sub>4</sub>, gur i kaltër dhe se sipas Tarifës së Integruar të Kosovës produkti në fjalë nuk ishte i liruar nga pagesa e taksave doganore.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kundër Doganës, përmes së cilës kërkoi anulimin e Aktvendimit [05.2.1/1244] për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 4 mars 2021, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A. nr. 1629/18] (i) e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe (ii) e anuloi Aktvendimin [05.2.1/1244] e Doganës, duke e kthyer për rishqyrtim tek kjo e fundit, pasi që konstatoi se i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme për ndryshimin e kodit tarifor dhe se në

nxjerrjen e Mendimit për klasifikimin tarifor të mallit, në të cilin ishte mbështetur Dogana, nuk ishte shqyrtuar dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor.

20. Më 17 maj 2021, Dogana, në rivendosje, përmes Aktvendimit [Nr. 05.2.1/1244/2012] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të Zyrës Doganore në Podujevë, me arsyetimin se nga analizimi i shkresave, Mendimit për Klasifikimin Tarifor nr. 53/2011 të Sektorit të Tarifës dhe sqarimit të 12 majit 2021 në lidhje me këtë mendim, ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës kishte bërë deklaram të pasaktë të kodit tarifor për mallin lëndor dhe se me të drejtë ishte obliguar që të paguajë detyrimet doganore.
21. Më 21 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë kundër Doganës, përmes së cilës kërkoi anulimin e aktvendimit të lartcekur të 17 majit 2021, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 7 prill 2023, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, përmes procesverbalit, i lejoi parashtruesit të kërkesës paraqitjen e fjalës përfundimtare me shkrim, me parashtresë të veçantë, në afat prej 3 (tri) ditëve.
23. Më 14 prill 2023, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, përmes Aktgjykimit [KF. nr. 278/2022], e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Aktvendimin [Nr. 05.2.1/1244/2012] e 17 majit 2021 të Doganës. Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë pranoi si të bazuar vendimin e kontestuar të Doganës dhe vlerësoi se parashtruesi i kërkesës, as në procedurën e zhvilluar para Doganës dhe as para gjykatës, nuk kishte paraqitur dëshmi për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes deklaratës unike doganore kontestuese, mbi bazën e të cilit duhej liruar nga pagesa e taksës doganore prej 10%.
24. Në arsyetimin e Aktgjykimit të lartcekur, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, duke iu referuar nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr. 03/L-109, theksoi se kishte qenë obligim i parashtruesit të kërkesës që të ofrojë prova konkrete për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar. Në këtë drejtim, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë vlerësoi se parashtruesi i kërkesës *“nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht Informatën Tarifore të detyrueshme nga BE-ja apo vendi eksportues ose i origjinës së mallit për Deklaratat unike Doganore kontestuese, për të vërtetuar pretendimin se vërtet malli lëndor klasifikohet në kodet tarifore siç janë deklaruar nga paditësi dhe jo ashtu siç janë ndryshuar nga e paditura në procedurë të zhdoganimit të mallit. [...]”*.
25. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, kundër Aktgjykimit [KF. nr. 278/2022] të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
26. Më 11 dhjetor 2023, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes Aktgjykimit [K. Dh. Sh. II. nr. 720/23] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin KF. nr. 278/2022] e 14 prillit 2023 të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, si të drejtë dhe të bazuar me ligj.

27. Përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësoi se Dogana me të drejtë kishte konstatuar se malli lëndor i deklaruar për zhdoganim klasifikohet në një kod tarifor të ndryshëm nga ai që kishte deklaruar parashtruesi i kërkesës dhe se duhej t'i nënshtrohej pagesës së taksave doganore. Për më tepër, në arsyetimin e këtij Aktgjykimi u konstatua si në vijim:

*“Në rastin konkret e paditura në pajtim me nenin 72 dhe 265 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, duke u referuar në Mendimin për klasifikim tarifor nga Sektori i Tarifës nr. 53-T/2011 të datës 16.12.2011, të konfirmuar me sqarim shtesë të datës 07.05.2021 të përcjell me emailin e datës 12.05.2021, ka ndryshuar kodin tarifor në deklaratën doganuese kontestuese, me ç'rast malli lëndor i është nënshtuar pagesës së taksave doganore”.*

28. Përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë e refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, respektivisht pretendimin se Informata tarifore detyruese e shtetit eksportues nuk është dokument i detyrueshëm. Në këtë aspekt, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë u theksua se sipas paragrafit 2 të nenit 18 të Kodit 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave, informata tarifore detyruese e shtetit eksportues është dokument obligues në rastet e klasifikimit tarifor. Më konkretisht, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësoi si në vijim:

*“[...]Pretendimet në ankesë se paditësi sa i përket gjendjes faktike ka dëshmuar certifikatën fitosanitare të vlerësuar nga inxhinieri i agronomisë dhe se Informata tarifore detyruese, e shtetit eksportues nuk është dokument i detyrueshëm nga neni 18 i Kodit Doganor dhe i Akcizave 03/L-109, Kolegji i Dhomës së shkallë së dytë, nuk i aprovoi si të bazuara këto pretendime ankimore, sepse nga provat e administruara në Dhomën e shkallës së parë, vlerëson se certifikata fitosanitare nr.021974 që gjendet në shkresat e lëndës, nuk është dokument relevant pasi që i takon një institucioni tjetër, dhe nuk është dokument i trajtuar nga e paditura Dogana e Kosovës, në procedim administrativ, prandaj si i tillë nuk mund konsiderohet si dokument që do të ndikonte në ndryshimin e klasifikimit tarifor të mallit lëndor.*

*Dispozita e nenit 18 paragrafi 2 i Kodit Doganor dhe i Akcizave 03/L-109, parasheh: Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor ose përcaktimin e origjinës së mallit. Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata. Prandaj Kolegji vlerësoi se sipas kësaj dispozite ligjore, Informata tarifore detyruese e shtetit eksportues, është dokument obligues për autoritet doganore, në rastet e kontestit të klasifikimit tarifor.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 1 të Protokollit Nr. 1, 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i (i) shkeljes së parimit të barazisë së armëve; (ii) zbatimit të gabuar të ligjit; dhe (iii) mosarsyetimit të vendimit gjyqësor.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për faktin se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë dhe të drejtë me palën e paditur. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë thekson se *“Në procesin gjyqësor, gjykata merr vendim duke u bazuar në kundërshtimet dhe fjalën përfundimtare të palës paditëse, ndërsa ajo vendimin në fjalë e merr pa pritur fare fjalën përfundimtare të palës paditëse edhe për kundër faktit se ajo me aktvendim pranon kërkesën e Paditësit që fjala përfundimtare t'i dorëzohet brenda afatit të caktuar”*.
32. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se fjala përfundimtare është çështje kryesore për vendimin e gjykatës që duhet të zë vend në arsyetimin e aktgjykimit dhe se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë ka shkelur parimin e barazisë së armëve pasi që ka pranuar fjalën përfundimtare të palës së paditur, ndërsa nuk ka pritur paraqitjen e fjalës përfundimtare të tij.
33. Parashtruesi i kërkesës, tutje, thekson: *“Në rastin aktual, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, nuk i trajton fare pretendimet tona të paraqitura në ankesën tonë. Por e njëjta konstaton se: "vlerësimi juridik i Dhomës së Shkallës së Parë është i rregullt dhe të bazuar në ligj dhe se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave ligjore dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LPK-se". Nuk mund të dijmë se ku ka shkelje më të madhe se sa mos trajtimi i barabartë i palëve në procedurë!”*.
34. Parashtruesi i kërkesës potencon se një çështje tjetër paradoksale e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë evidentohet edhe ndërmjet datës së përpilimit të Aktgjykimit të 14 prillit 2023 dhe datës së dorëzimit të tij në postë më 13 prill 2023. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës shton: *“Sipas kësaj, gjykata pretendon se Aktgjykimin e ka përpiluar me datë 14 prill 2023, ndërsa dorëzimi në postë është me datën 13 prill 2023! Pyetja është e thjeshtë: Si mund të dorëzohet në postë një Aktgjykim një ditë para se të përpilohet?! Vërtetë Paradoksale! Kjo çështje e bënë të dyshimtë të gjithë vendimin e gjykatës”*.
35. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, respektivisht të nenit 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi që sipas tij informata tarifore detyruese lëshohet në bazë të kërkesës dhe nuk është e detyrueshme ligjrisht. Tutje, lidhur me Tabelën e Regjistrimit të Plehrave Artificialë të regjistruar në MPZHR, të cilës Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë nuk i fali besimin, parashtruesi i kërkesës thekson se shifrat doganore për kategorizimin e mallit janë të njëjta si për vitin 2021 ashtu edhe për vitin 2023.
36. Sipas parashtruesit të kërkesës, përmes interpretimit të gabuar të nenit 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, shkalla e dytë e Gjykatës Komerciale ka kufizuar trajtimin e

ankesës vetëm në kuptim të Informatës Detyruese Tarifore nga shteti eksportues dhe i origjinës së mallit, duke lënë pa trajtuar të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit relevante për rastin në fjalë, siç është bazueshmëria e kërkesës për anulimin e vendimit dhe detyrimit për ndryshimin e kodit doganor.

37. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, thekson se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se vendimi i arsyetuar u tregon palëve që janë dëgjuar dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih, rastin e Gjykatës KI72/12, parashtrues [Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012; dhe rastin e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994).
38. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së pasi që edhe pse mjeti juridik ka qenë në dispozicionin e tij dhe të njëjtin e ka shfrytëzuar, efektiviteti i tij ka qenë inekzistent.
39. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të konstatojë se kërkesa është e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6, 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe të neneve 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së; dhe (iii) të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës.

## **DISPOZITAT PËRKATËSE KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

*[...]”*

#### **Neni 32**

#### **[E Drejta për Mjete Juridike]**

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

#### **Neni 54**

#### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*

### **Neni 119** **[Parimet e Përgjithshme]**

- 1. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.*
- 2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.*
- 3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.*
- 4. Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.*
- 5. Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.*
- 6. Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.*
- 7. Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.*
- 8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.*
- 9. Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.*
- 10. Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.”*

## **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Neni 6** **(E drejta për një proces të rregullt)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.*

### **Neni 13** **(E drejta për zgjidhje efektive)**



*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

### **Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrotja e pronës )**

*“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.*

## **DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Neni 7**

*“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrotje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë”.*

### **Neni 8**

*“Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë a me ligj”.*

### **Neni 10**

*“Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij”.*

## **Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë**

### **Neni 18**

*“1. Dogana do të lëshojë informacion të detyrueshëm tarifor ose informacion të detyrueshëm të origjinës në bazë të kërkesës me shkrim, duke vepruar në përputhje me dispozitat për zbatimin e këtij Kodi.*

*2. Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor ose përcaktimin e origjinës së mallit.*

*Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata.*

*Në çështjen e origjinës, formalitetet në fjalë do të jenë ato që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit 26 dhe 31.*

[...]

#### **Neni 72**

*“1. Për të kryer verifikimin e deklaratave të pranuar, Dogana mund:*

- a) Të kontrollojë dokumentet që i janë bashkangjitur deklaratës dhe dokumentet shoqëruese. Dogana mund të kërkojë nga deklaruesi të paraqet dokumente të tjera për të verifikuar saktësinë e të dhënave nga deklarata;*
- b) Të kontrollojë mallrat dhe të merr mostra për analizë ose për ekzaminime më të hollësishme”.*

### **Udhëzimi Administrativ Nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109**

#### **Seksioni 4**

#### **Dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore**

#### **Neni 123**

*“1. Dokumentet ne vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë:*

- a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti;*
- b) Kur kërkohet sipas Nenit 88 të këtij akti, deklarata për vlerat doganore të mallrave të deklaruarra i bëjnë në përputhje me kushtet e paraqitura në nenin e dhënë;*
- c) Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruarra;*
- d) Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirinë për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruarra”.*

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

40. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

#### *Neni 21*

*[...]*

- 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

#### *Neni 113*

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*  
[...]

42. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”*

[...]

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës [KI41/09](#), parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40). Po ashtu, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, si palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [K. Dh. Sh. II. nr. 720/23] e 11 dhjetorit 2023 të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së dytë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
44. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, paragrafi (2) i rregullit 34 përcakton:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

45. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
46. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih rastet e Gjykatës [Kl04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 26; dhe [Kl107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2021, paragrafi 53).
47. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
48. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me faktin se malli lëndor që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur për zhdoganim, sipas vendimit të Zyrës Doganore në Podujevë, nuk klasifikohet si *“fungicid”* siç kishte deklaruar parashtruesi i kërkesës, por si *“sulfat bakri”* që i nënshtrohet pagesës së taksave doganore. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Doganë kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi, kërkesë e cila u refuzua si e pabazuar. Më pas, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi kundër Doganës, në Gjykatën Themelore, padi e cila u aprovua si e bazuar. Gjykata Themelore e ktheu lëndën për rishqyrtim tek Dogana, pasi që konstatoi se i njëjti nuk përmbante arsye të mjaftueshme për ndryshimin e kodit tarifor dhe se në nxjerrjen e Mendimit për klasifikimin tarifor të mallit nuk ishte shqyrtuar dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor. Në rivendosje, Dogana, refuzoi kërkesën për rishqyrtim të vendimit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës me arsyetimin se nga analizimi i shkresave vërtetohej se parashtruesi i kërkesës kishte bërë deklaram të pasaktë të kodit tarifor për mallin lëndor. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, padi e cila u refuzua si e pabazuar nga kjo e fundit me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur dëshmi për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes deklaratës unike doganore kontestuese dhe se nuk kishte ofruar si provë Informatën Tarifore të detyrueshme nga BE-ja apo vendi eksportues ose i origjinës së mallit. I pakënaqur me këtë aktgjykim, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, ku kjo e fundit refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi

Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, si të drejtë dhe të bazuar me ligj.

49. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e mësipërme të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë dhe të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë me pretendimin se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i (i) shkeljes së parimit të barazisë së armëve; (ii) zbatimit arbitrar të ligjit; dhe (iii) mosarsyetimit të vendimit gjyqësor. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të neneve 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6, 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

***Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

(i) *Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit të barazisë së armëve*

50. Fillimisht, Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtresave, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [Kraska kundër Zvicrës](#), nr. 13942/88, Aktgjykim i 19 prillit 1993, paragrafi 30). Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtë i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih, rastin e GJEDNJ-së [Regner kundër Republikës Çeke](#), nr. 35289/11, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).
51. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e ka ndjekur edhe Gjykata, është theksuar në vazhdimësi se parimi i barazisë së armëve kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*”, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme që të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, në raport me palën kundërshtare (shih, rastet e GJEDNJ-së [Regner kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafi 146; [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31; dhe shih rastet e Gjykatës [KI193/19](#), parashtrues [Salih Mekaj](#), Aktgjykim i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 57; dhe [KI89/22](#), parashtrues [Xhelal Plakolli](#), Aktvendim për Papranueshmëri i 7 marsit 2023, paragrafi 60).
52. Duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, parimi i barazisë së armëve është i rëndësishëm, e sidomos në çështjet penale dhe ky parim zbatohet në të gjitha fazat e gjykimit, duke përfshirë edhe procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet vendimit të GJEDNJ-së, në rastin [Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), ku GJEDNJ konstatoi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër (parashtruesin e kërkesës) e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurën para Gjykatës Supreme (shih, rastin e GJEDNJ-së [Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 21510/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, paragrafi 39).

53. GJEDNJ ka theksuar në vazhdimësi se i takon asaj për të vendosur se a janë zhvilluar procedurat e kontestuara, si tërësi, në përputhje me Konventën, duke përfshirë edhe nenin 6 të saj. Në këtë sfond, sipas GJEDNJ-së, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kraska kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafi 30; dhe [Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83. Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988).
54. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë ka shkelur parimin e barazisë së armëve pasi që nuk ka pritur paraqitjen e fjalës përfundimtare të tij ndërkohë që ka pranuar fjalën përfundimtare të palës së paditur. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se ka mospërputhje ndërmjet datës së përpilimit të aktgjykimit të kësaj gjykate dhe dorëzimit në postë të ti, duke shtuar: *“Sipas kësaj, gjykata pretendon se Aktgjykimin e ka përpiluar me datë 14 prill 2023, ndërsa dorëzimi në postë është me datën 13 prill 2023! Pyetja është e thjeshtë: Si mund të dorëzohet në postë një Aktgjykim një ditë para se të përpilohet?! Vërtetë Paradoksale! Kjo çështje e bënë të dyshimtë të gjithë vendimin e gjykatës”*.
55. Në vazhdim, dhe në lidhje me pretendimin se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë nuk ka pritur dhe nuk ka marrë parasysh fjalën përfundimtare të tij, Gjykata fillimisht rikujton se në seancën e shqyrtimit kryesor të 7 prillit 2023, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, i kishte lejuar parashtruesit të kërkesës paraqitjen e fjalës përfundimtare me shkrim, me parashtrësë të veçantë, në afat prej 3 (tre) ditësh.
56. Gjykata vëren se në arsyetimin e Aktgjykimit [KF. nr. 278/2022] të 14 prillit 2023, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë është mbështetur edhe në fjalën përfundimtare të parashtruesit të kërkesës, ku ndër tjera është theksuar se *“Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: e paditura nuk ka marrë për bazë rekomandimet e gjykatës [...]”*.
57. Për më tepër, nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar fjalën përfundimtare përmes parashtrësës me 12 prill 2023 dhe në po të njëjtën ditë ishte pranuar nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë.
58. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mospërputhje ndërmjet datave përkritazi me Aktgjykimin e 14 prillit 2023 të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Gjykata vëren se nga fletëkthesa e dorëzimit të këtij Aktgjykimi vërehet se i njëjti i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 prill 2023 dhe në fletëkthesë nuk pasqyrohet ndonjë datë tjetër.
59. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë ka shkelur parimin e barazisë së armëve, për faktin se nuk kishte pritur fjalën përfundimtare të tij, sepse nga arsyetimi i Aktgjykimit të kësaj gjykate vërehet se kjo e fundit ishte mbështetur në fjalën e tij përfundimtare si dhe nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar fjalën e tij përfundimtare me 12 prill 2023 ndërkaq që Aktgjykimi ishte shpallur më 14 prill 2023.
60. Gjykata gjithashtu e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të

KEDNJ-së nuk është drejtësi *substancialë*, por drejtësi *procedurale*. Në rrafshin praktik, koncepti i drejtësisë procedurale nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, rastin e GJEDNJ-së [Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues [Sabit Ilazi](#), Aktvendim i 8 majit 2019, paragrafi 42).

61. Prandaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme dhe bazuar në parimet e përgjithshme mbi të drejtën për barazi të armëve, Gjykata konsideron se ka pasur “ekuilibër të drejtë ndërmjet palëve” dhe se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia për të paraqitur dhe argumentuar rastin e tij. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës para Gjykatës Komerciale, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

62. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i cenimit të parimit të barazisë së armëve, i përket kategorisë së (iii) pretendimeve të “pambështetura apo të paarsyetuara”, dhe i njëjti duhet të shpallet qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(ii) *Lidhur me pretendimin për zbatim arbitrar të ligjit*

63. Përkitazi me zbatimin e gabuar të ligjit, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë ka zbatuar gabimisht nenin 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi që sipas tij informata tarifore detyruese lëshohet në bazë të kërkesës dhe nuk është e detyrueshme ligjërish.

64. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin ndërmjet “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” duke theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues [Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”](#), Aktvendim për Papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 55; dhe [KI110/19](#), parashtrues [Fisnik Baftijari](#), Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafi 40).

65. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih rastet e Gjykatës [KI128/18](#),

parashtrues *Limak Kosovo International Airport Sh.A. "Adem Jashari"*, cituar më lart, paragrafi 56 dhe [KI94/22](#), parashtrues *Vejsel Rugova*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 tetorit 2022, paragrafi 64).

66. Gjykata, megjithatë, thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të përvetësuar nga Gjykata, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerri masa kur vëren se një gjykatë ka zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik i cili mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Anheuser-Busch Inc., kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 108; si dhe rastin e Gjykatës [KI122/16](#), parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 59).
67. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur përmes ankesës së tij parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë konstatoi se informacioni tarifor detyrues i shtetit eksportues është dokument obligues për autoritetet doganore, duke theksuar si në vijim:

*"[...] Dispozita e nenit 18 paragrafi 2 i Kodit Doganor dhe i Akcizave 03/L-109, parasheh: Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor ose përcaktimin e origjinës së mallit. Informacioni tarifor i detyrueshëm ose informacioni i detyrueshëm i origjinës është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata. Prandaj Kolegji vlerësoi se sipas kësaj dispozite ligjore, Informata tarifore detyruese e shtetit eksportues, është dokument obligues për autoritet doganore, në rastet e kontestit të klasifikimit tarifor."*

68. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se si zbatimi i ligjit nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" për të.
69. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për zbatim arbitrar të ligjit i përket kategorisë së pretendimeve "të shkallës së katërt" dhe i njëjti është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

*(iii) Lidhur me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor*

70. Përkitazi me pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë ka kufizuar trajtimin e ankesës vetëm në kuptim të Informatës Detyruese Tarifore nga shteti eksportues dhe nuk ka trajtuar çështjet e faktit dhe të ligjit siç është bazueshmëria e kërkesës për anulimin e vendimit dhe detyrimit për ndryshimin e kodit doganor.
71. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në



praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999; si dhe rastet e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022; dhe [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

72. Në parim, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI143/22](#), cituar më lart, paragrafi 116).
73. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, rastet e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 29; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 42; dhe shih rastet e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 48).
74. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë e apelit mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30).
75. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësve të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsye për vendimet e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 36). Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument, argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen (shih, rastin e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 61).
76. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritave dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Vendimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, rastet e Gjykatës [KI72/12](#), [Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012, paragrafi 61; dhe [KI97/16](#), *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 52).
77. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë nuk ka trajtuar çështjet e faktit dhe të ligjit siç është bazueshmëria e

kërkesës për anulimin e vendimit dhe detyrimit për ndryshimin e kodit doganor, Gjykata rikujton se në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar lidhur me ndryshimin e kodit doganor, është theksuar si në vijim:

*“Në rastin konkret e paditura në pajtim me nenin 72 dhe 265 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, duke u referuar në Mendimin për klasifikim tarifor nga Sektori i Tarifës nr. 53-T/2011 të datës 16.12.2011, të konfirmuar me sqarim shtesë të datës 07.05.2021 të përçjell me emailin e datës 12.05.2021, ka ndryshuar kodin tarifor në deklaratën doganuese kontestuese, me ç’rast malli lëndor i është nënshtruar pagesës së taksave doganore.”*

78. Më tej, Gjykata vëren se, përmes Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, ishin të pabazuara dhe pa ndikim për të vendosur ndryshe çështjen në fjalë.
79. Gjykata rikujton edhe një herë se neni 31 i Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim. Në veçanti, në refuzimin e një ankese, siç është rasti konkret, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, në parim, thjesht ka mundur që të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale (shih, rastin e GJEDNJ-së, [\*García Ruiz kundër Spanjës\*](#), cituar më lart, paragrafi 26).
80. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë ka adresuar dhe u është përgjigjur pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes ankesës dhe si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë plotëson standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.
81. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, i përket kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe i njëjti është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

***Lidhur me pretendimin për shkelje të neneve 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës në lidhje me nenet 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe neneve 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së***

82. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës në lidhje me nenet 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe me nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.
83. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet e mëposhtme:

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjeshtë citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005);
- b) kur parashtruesi kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
84. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës në lidhje me nenet 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe me nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së, mirëpo i njëjti nuk shtjellon më tej si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e tyre nga ana e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata përsërit qëndrimin e saj se vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese, pasi që duhet të paraqiten dëshmi dhe argumente bindëse, për të dëshmuar shkeljet e pretenduara (shih, rastet e Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafi 81; dhe [KI166/20](#), parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52).
85. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## Përfundim

86. Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se:
- pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i shkeljes së parimit të barazisë së armëve dhe mosarsyetimit të vendimit gjyqësor i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura dhe të paarsyetuara*” ndërkaq pretendimet për zbatim arbitrar të ligjit i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, dhe të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
  - pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 32, 54 dhe 119 të Kushtetutës në lidhje me nenet 13 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe me nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së, i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura dhe të paarsyetuara*” dhe të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani